PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Dona-Impex" SH.P.K. – Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik N.T.P. "B&L"-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me aparat saldimi MIG 500A", me nr. të prokurimit: "KEK-20-3880-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës sh.a, më datën: 02.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Dona-Impex" SH.P.K. – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me aparat saldimi MIG 500A",, me nr. të prokurimit: "KEK-20-3880-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.

II. **VËRTETOHET**, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me aparat saldimi MIG 500A",, me nr. të prokurimit: "KEK-20-3880-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës sh.a..

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Dona-Impex" SH.P.K. – Prishtinë, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "Dona-Impex" SH.P.K. – Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 30.10.2020 me nr. 869/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me aparat saldimi MIG 500A",, me nr. të prokurimit: "KEK-20-3880-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës sh.a, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 59 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 39 te RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 02.11.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.
Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 10.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:
Përgjigje në pretendimet ankimore te OE ankues

Eksperti shqyrtues teknik pas shqyrtimit në detaje të pretendimit të OE ankues, analizimit të DT, NJK, specifikacionit teknik, përshkrimi i çmimeve vendimeve të AK, kërkesave për sqarime dhe fakteve të kësaj ekspertize mendon që AK ka vepruar në kundërshtim me nenët 1, 6, 59, 72 të LPP-së.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1 dhe 2: Nenin 1 dhe Neni 6
Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të OE "Dona-Impex" SH.P.K. – Prishtinë lidhur me anulimin e ofertës së tyre nga AK - Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.. për çmimin e

ofertës sqaron se AK ka vepruar në kundërshtim me RROUP dhe LPP. Andaj pretendimi ankimor i OE se ka dorëzuar ofetën me çmimin më të ulët në vlerë 4,221.80 € ndërsa AK në kundërshtim me nenin 1 dhe 6, të LPP ka shpallur fitues OE i cili është me çmimin më të lartë. Ky pretendim është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3 dhe 4: Neni 59 dhe Neni 72

Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të OE "Dona-Impex" SH.P.K. – Prishtinë, sqaron se AK dhe komisioni vlerësimit kanë vepruar në kundërshtim me Nenin 59 pika 2 dhe 4 në këtë procedurë të prokurimit, AK - Korporata Energjetike e Kosovës sh.a ka vendosur si kriter në NJK dhe DT se Autoriteti Kontraktues do ti jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët, AK dhe komisoni vlerësimit gjatë vlerësimit është dashur që ta vlerësojn ofertën e OE ankues sipas nenin 59, dhe për informacione dhe materialet të cilat komisoni nuk ka mundur ti vlerësoj, si në rastin e vendit të prodhuesit (Danimarke – Suedi). Ne të gjitha katalogjet e dorëzuara nga OE në rastin e dorëzimit të ofertavene e-prokurim ceket se Prodhuesi Migatronic është me seli në Denmark, DK-9690 Fjerritslev, Aggersundvej 33. E verifikuar edhe nga ne ne ueb faqen ëëë.migatronic.com . Nërsa në ofertën financiare OE ka vendosur vendin e origjines Suedi. Komisoni vlerësues është dashur të kërkojnë infrmacione shtesë në përputhje me nenin 59.2 dhe nenin 72.

Tek specifkacionet teknike dhe katalogjet lidhur me ofrimin e produketeve spas kërkesave në dosjen e tenderit, OE ka nënshkruar një deklaratë ku deklarohet se mallrat e ofruar nga OE Dona –Impex janë në përputhje me Aneksin 1 të specifkacionit teknik të detyrueshëm. AK – dhe komisoni vlerësimit duhet të vlerësojnë specifkacionet teknike sipas LPP nenit 59 dhe specifkacione teknike apo informacione të cilat nuk mund të vlerësohen nga komisoni vlerësues të kërkoj informacione shtese. Mirëpo AK duhet të kërkoj informacione shtesë për dokumentacionin i cili është pjese e aplikimit fillestar, dhe asesi të ndryshoj materialet por materialet ekzistuese vetëm të sqarohen. Ky pretendim është pjesërisht i bazuar

Eksperti shqyrtues teknik sqaron që AK dhe komisoni i vlerësimit gjatë procedurës së rivlerësimit duhet të kryejn vlerësim profesional duke respektuar nenët 1, 6, 7, 59, 72 të LPP-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet dhe të gjeturat në ketë ekspertizë, eksperti shqyrtues teknik i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht të bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim për këtë aktivitet të prokurimit.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 18.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **Nuk**

Pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Plotesim te emailit te derguar per mos pajtim raportin e ekspertit shqyrtues te ankese nga konisioni ne vijim :

1. Përshkrimi i çmimit nga OE "Dona-Impex" SH.P.K. me përmbajtje te gabueshme te prodhuesit Poloni/Danimark, nuk ka qen përcaktuese për tu shpall i pa pergjegjshem.
2. Përcaktuese ka qene devijimi nga karakteristikat teknike.

Specifimet teknike te detyrushme nuk po lexohen drejt dhe sakt nga OE dhe eksperti shqyrtues.

P.sh. karakteristikat e aparatit dhe dorezes:

"Fuqija: (10-500)A"; " ta perballoj fuqinë punuese me CO2(450-650)A" etj. nuk duhet te mirren si intervale te paisjes se kerkuar se po te ishte ashtu OE do ta sillte një aparat me fuqi 100A dhe do te arsyetohej se është mbrenda intervalit te kërkuar.

Jo, nuk jane intervale dhe jo rastesishte është kerku "fuqi punuese" qe d.m.th. paisja ti realizoj ato vlera te skajshme.

Kjo i bije se aparati duhet ta realizoj edhe vlerën e fundme te fuqisë 500A, kurse dorza për saldim ta "perballoj" fuqin punuese me CO2, 650A !!!

Kerkesa do te munde te shkruhej edhe si :"Te berballoj fuqine punuese me CO2- 650A", pra do ta kishte te njejtin "kuptim Fizik" sepse kur dorza e perballon fuqin punuese 650A aq me pare e perballon edhe vlerat me te uleta!

3. Vetem po i prezentoj nje vend (se bashku) kerkesen (fq.16 te dosjes se tenderit- te specifikimet teknike te detyrueshme) dhe oferten ne katalog nga prodhuesi:

"-Mundesia e qarkullimit te lengut ftohes minimum 2.8 l/min" ne kerkes

"Min.protok tečnosti pri pritisku 1 bar 1l/min. Ne katalogun e prodhuesit

Pra minimumi i kerkuar 2.8l/min e ofrohet 1l/min.

Pretendimi i OE se kjo sasi e rrjedhjes eshte per presion minimal 1 bar jape qarkullim (prurje) 1l/min e per presion ma te laret jepe qarkullim ma te larte te lengut, pajtojmi por ne kemi kerku "minimum 2.8 l/min" e OE po na ofron minimum 1l/min!

Operatori Ekonomik, me datë: 14.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **Pajtohet** me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 02.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të

prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimit për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Dona-Impex" SH.P.K. – Prishtinë, se AK e ka eliminuar OE ankues edhe pse ka ofertën me çmimin më të lirë, Paneli Shqyrtues sqaron se neni 60 i LPP-së ka përcaktuar autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Në rastin konrekt, OE ankues nuk i përmbush specifikimet teknike dhe kjo nuk e bën tender i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues "Dona-Impex" SH.P.K. – Prishtinë, se AK ka bërë vlerësimin në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe se AK gjatë vlerësimit është dashur që ta vlerësojnë ofertën e OE ankues sipas nenit 59, dhe për informacione dhe materialet të cilat komisioni nuk ka mundur ti vlerësoj, si në rastin e vendit të prodhuesit (Danimarke – Suedi).
Paneli Shqyrtues sqaron se pas pranimit të shkresës nga autoriteti kontraktues, jepen sqarime konkrete se përshkrimi i çmimit nga OE ankues me përmbajtje të gabueshme të prodhuesit Poloni/Danimarkë nuk ka qenë përcaktuese për tu shpall i pa përgjegjshëm. Por, devijimi nga karakteristikat teknike e ka bërë të pa përgjegjshme OE ankues. Konkretisht, karakteristikat e aparatit dhe dorezes, ku fuqia: (10-500)A";" ta përballoj fuqinë punuese me CO2(450-650)A" etj. Këto, nuk duhet të merren si intervale të pajisjes seë kërkuar dhe po te ishte ashtu, OE do ta sillte një aparat me fuqi 100A dhe do të arsyetohej se është brenda intervalit të kërkuar. Këto tipare nuk janë kërkuar rastësisht sikurse "fuqi punuese", që do të thot pajisja ti realizoj ato vlera të skajshme. Sipas përshkrimit që bën AK, rezulton se aparati duhet ta realizoj edhe vlerën e fundme te fuqisë 500A, kurse dorëza për saldim ta "perballoj" fuqin punuese me CO2, 650A. Po ashtu, kërkesa (fq.16 të dosjes së tenderit- te specifikimet teknike të detyrueshme) dhe oferta në katalog nga prodhuesi: "-Mundesia e qarkullimit te lengut ftohes minimum 2.8 l/min" në kërkesë, kurse "Min.protok tečnosti pri pritisku 1 bar 1l/min" në katalogun e prodhuesit. Pra, minimumi i kërkuar 2.8l/min e ofrohet 1l/min. Për më shumë, AK ka kërkuar minimum 2.8 l/min kurse OE ka ofruar 1l/min. Andaj, Paneli Shqyrtues duke u bazuar në sqarimet të cilat i ka dhënë autoriteti kontraktues, konsideron se OE ankues nuk I ka përmbushur specifikimet teknike të detyrueshme.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vlerëson se autoriteti kontraktues me të drejtë e ka eliminuar OE ankues pasi i njëjti nuk i përmbush specikimet teknike të detyrueshme. Po ashtu,

Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.;

1x1 OE "Dona-Impex" SH.P.K. – Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.